Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

PËRTEJ KUFIJVE TË SHKOLLËS

NJË PERSPEKTIVË PËR NDËRTIMIN E KOMUNITETEVE TË QËNDRUESHME PËRMES MODELIT SHKOLLA QENDËR KOMUNITARE

Ky botim është përgatitur në kuadër të projektit “Fuqizimi i komunitetit lokal në parandalimin e çdo forme të ekstremizmit të dhunshëm nëpërmjet masave parandaluese shumë-aktoriale në Bashkinë Kamëz”, i zbatuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian nëpërmjet Qendrës së Ekselencës për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm Hedayah.
Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim dhe nuk shpreh në asnjë mënyrë pikëpamjet e Bashkimit Evropian apo ato të Hedayah.

Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian

Hedayah
countering violent extremism

Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim
IDM

Shkolla Qendër Komunitare

PËR KOMUNITETE TË QËNDRUESHME

CONCEPT AND DESIGN: EDUART CANI

përse shkolla si qendër komunitare?

a) **është një instrument që vendos shkollën në qendër të komunitetit**, që **ndërlidh** institucionet në nivel vendor dhe forcon lidhjen e stafit të shkollës me nxënësit dhe prindërit, për të forcuar **kohezionin** në përballimin e sfidave të sigurisë dhe ekstremizmit të dhunshëm.

b) **nxit përgjegjësinë dhe vendim-marrjen e përbashkët** të secilit prej aktorëve të përfshirë – duke respektuar diversitetin, duke mbështetur shkollën dhe duke i shërbyer mirëqenies së komunitetit.

c) **e çon rolin e shkollës përtej "tradicionales"** për t'u fokusuar në **vlerat shoqërore e demokratike**, për të siguruar **mirëqenien sociale, psikologjike** dhe **shëndetësore** të nxënësve dhe për të fuqizuar familjen.

d) **zhvillon kapacitetet** e shkollës, zhvillon **aftësitë** e të rinjve, dhe nxit **pjesëmarrjen** e tyre aktive në komunitet.

Një **komunitet** është i **QËNDRUESHËM** kur **zotëron aftësi** dhe **nxit angazhimin** aktiv të aktorëve të ndryshëm vendorë në komunitet, duke **përdorur gjithë burimet** (njerëzore, ligjore dhe financiare) në përgjigje të problematikave dhe fenomeneve të ndryshme, përfshirë dhe atë të ekstremizmit të dhunshëm.

bashkia
1. Kryetari i bashkisë
2. Këshilli bashkiak
3. Këshillat Vendorë të Sigurisë Publike
4. Shërbime dhe struktura të tjera të bashkisë
grupet komunitare
biznesi
media
ShQK
personat me influence
OShC
komunitete fetare
grupet rinore
shkolla
1. Stafi mësimor
2. Qeveritë e nxënësve
3. Bordet e prindërve
4. Shërbimi psiko-social
policia
1. Ruajtjen e rendit dhe sigurisë vendore
2. Parandalimin e fenomeneve që cënojnë sigurinë dhe mirëqenien e komunitetit

vizioni dhe përgjegjësia e përbashkët

“Shkolla Qendër Komunitare” përbën një instrument të rëndësishëm në forcimin e komuniteteve vendore nëpërmjet arsimimit, zhvillimit të kapaciteteve, nxitjen e qytetarisë aktive, fuqizimin e grave, si dhe informimin dhe ndërgjegjësimin e komunitetit për të luftuar intolerancën, diskriminimin dhe paragjykimet. Ky model synon ta kthejë shkollën në vendin ku ndërtohet **partneriteti midis institucioneve vendore – shkollës – familjes – komunitetit – grupeve të interesit**, si një mjedis që është në shërbim dhe në bashkëveprim me komunitetin; që kontribuon në zhvillimin e të rinjve dhe nxit qytetarinë aktive; që mbështet zhvillimin e komuniteteve si nga pikëpamja e sigurisë vendore ashtu dhe në atë të angazhimit të tyre në vendimmarrje dhe rritjen e demokracisë vendore.
Eksperienca e ngritur mbi modelin “Shkolla Qendër Komunitare”, ndërthur ndërveprimin e institucioneve vendore ndërmjet njëri-tjetrit, me komunitetet vendore dhe me grupet e interesit:

- Kryetari i Bashkisë Kamëz, Këshilli Bashkiak, dhe strukturat përkatëse të Bashkisë forcojnë angazhimin në fushën e sigurisë dhe të parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm. Eksperienca dëshmon se angazhimi i këtyre institucioneve në zbatimin e planit të punës për “Shkollat Qendër Komunitare” është një mundësi për sukses në përmirësimin e këtyre shërbimeve ndaj qytetarëve.
- Komisariati i Policisë Kamëz është aktor i rëndësishëm në këtë bashkëpunim. Nëpërmjet pjesëmarrjes në aktivitete, policia vendore plotëson objektivat e saj të punës në kuadër të planit vendor të “Policimit në komunitet”. Policia realizon komunikime periodike me komunitetin e prindërve, nxënësve, të rinjve dhe adreson problematika të ndërsjellta me këta aktorë, në mënyrë proaktive, në një fazë të hershme.
- Shkolla mundëson formësimin e të rinjve, përmes ofrimit të dijeve akademike dhe përgatitjes së tyre për të qenë qytetarë aktive në shoqëri. Stafi i shkollës, së bashku me psikologun dhe oficerin e sigurisë, mundësojnë lehtësimin e këtij procesi përmes shkëmbimit të informacioneve, aktivizimit social dhe kulturor, dhe bashkëpunimit me të gjithë aktorët e tjerë lokalë.

shembuj
të praktikës
së mirë

Përmirësimi i kapaciteteve të shkollës si një vend i sigurt për të promovuar modelin Shkolla Qendër Komunitare, si një instrument në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm

- Ngritja e Grupit Këshillimor të Shkollës Qendër Komunitare, me përfshirjen e të gjithë aktorëve në nivel vendor – Bashkia, Policia, Zyra Arsimore, Shkolla, Nxënësit. Ky grup ka në fokus të tij aktivizimin dhe forcimin e zërit të të rinjve në nivel vendor dhe forcimin e marrëdhënieve multi-aktoriale në komunitet.
- Hartimi dhe zbatimi i planit të përvitshëm të aktiviteteve të Shkollës Qendër Komunitare, në bashkëpunim me prindërit, stafin e shkollës, nxënësit, komunitetin, dhe institucionet vendore.
- Përmirësimi i mjediseve të shkollës dhe ofrimi i mundësive për zhvillimin e të rinjve, përmes sigurimit të pajisjeve kompjuterike, librave dhe materialeve të tjera mbështetëse.
- Hartimi i Planit të Veprimit për Komunitete të Qëndrueshme, për një qasje më të gjerë të pushtetit vendor ndaj komunitetit lokal dhe të rinjve në veçanti, duke synuar rritjen e aftësive ripërtëritëse të komunitetit dhe krijimin e komuniteteve sa më të shëndetshme.

Fuqizimi i kapaciteteve të të rinjve dhe nxitja e angazhimit qytetar

- Trajnime tematike dhe aftësim profesional për nxënësit në fushën e menaxhimit të konfliktit, edukimit mediatik, teknologjisë së informacionit, fuqizimit të vajzave dhe grave në tregun e punës dhe këshillimit të karrierës për të rinjtë.
- Sesione informuese kundër ekstremizmit të dhunshëm me nxënësit e vitit të dytë të gjimnazit "Ibrahim Rugova", me ndihmën e psikologes dhe oficerit të sigurisë në shkollë.
- Mbështetja e talenteve në shkollë, përmes krijimit të klubit të pikturës dhe angazhimit të të rinjve në realizimin e fushatave ndërgjegjësuese kundër ekstremizmit të dhunshëm.
- Takime të përbashkëta dhe shkëmbim përvojash midis mësuesve, nxënësve dhe prindërve të të gjitha gjimnazeve të Kamzës.
- Nxitja e vullnetarizmit tek të rinjtë dhe aktivizimi i tyre në nisma komunitare.



Advokimi i prioriteteve të të rinjve dhe vajzave e grave në nivel vendor

- Krijimi i Klubit të të Rinjve për Demokracinë dhe i Klubit të të Rinjve për Fuqizimin e vajzave dhe grave.
- Angazhimi i të rinjve në praktika vullnetare pranë Bashkisë Kamëz, duke nxitur besimin dhe krijimin e marrëdhënieve ndërvepruese të të rinjve me institucionet vendore.
- Manifesti i prioriteteve të të rinjve lidhur me qeverisjen vendore dhe fuqizimin e grave dhe vajzave.
- Nxitja e zhvillimit të aftësive qytetare dhe njohurive të të rinjve mbi qeverisjen vendore dhe të drejtat e vajzave dhe grave.

Promovimi i gjithë-përfshirjes dhe ndërgjegjësimi për respektimin e diversitetit

- Takime periodike diskutimi të udhëhequra nga psikologu i shkollës dhe oficeri i sigurisë, me stafin mësimor dhe nxënësit mbi respektimin e diversitetit, gjithë-përfshirjen dhe shmangien e çdo lloj forme të diskriminimit.
- Aktivitete ndërgjegjësuese nga vetë të rinjtë kundër diskriminimit dhe paragjykimit.
- Aktivitete informuese me të rinjtë dhe prindërit në bashkëpunim me institucionet ligj-zbatuese dhe komunitetet fetare për fenomene si ekstremizmi i dhunshëm, bullizmi, dhuna në familje.
- Takime informuese ndërgjegjësuese ndërmjet përfaqësuesve të komisariatit të policisë dhe nxënësve e komunitetit mbi substancat narkotike, duhanin, alkoolin, etj; menaxhimin e situatave problematike dhe nxitja e raportimit në institucionet kompetente për shkeljet ligjore.

për një zbatim
të suksesshëm

- Përfshirje më e madhe e aktorëve vendorë, si dhe e komunitetit të prindërve, në hartimin e planit vjetor të Shkollës Qendër Komunitare, duke nxitur përgjegjësitë dhe mundësitë për mbështetje në realizimin e aktiviteteve;
- Bashkërendimi i punës dhe i aktiviteteve në nivel vendor me njësitë e qeverisjes vendore dhe institucionet e tjera, duke pasur në qendër aktivitetet SHQK;
- Zhvillimi i një qasjeje proaktive ndaj të rinjve përmes aktivizimit të tyre për t'i dhënë zgjidhje problematikave në komunitet;
- Adaptimi i praktikave të përvitshme vullnetare të të rinjve pranë institucioneve vendore si një mundësi për të rritur besim tek qeverisja vendore dhe ndihmuar zhvillimin e të rinjve;
- Ofrimi i më shumë trajnimeve/sesioneve informuese në fushën e këshillimit të karrierës në mënyrë që të rinjtë të orientohen më lehtë në tregun e punës apo të studimeve universitare;
- Lehtësimi i komunikimit me bizneset e zonës dhe krijimi i hapësirave të përshtatshme për ngritje kapacitetesh dhe përfshirje të të rinjve në programet e praktikave të punësimit;
- Rritja e qasjes së përfaqësuesve të policisë ndaj të rinjve përmes përfshirjes në aktivitete të përbashkëta informuese, ndërgjegjësuese apo dhe sportive.
- Mbështetja e nismave rinore, veçanërisht atyre që rrisin vetëdijen dhe angazhimin e të rinjve në vendimmarrjen vendore;
- Avancimi i dialogut ndërkulturor përmes mbështetjes të të rinjve dhe grupeve të ndryshme të shoqërisë në luftimin e diskriminimit dhe promovimin e një kulture gjithëpërfshirëse;
- Rritja e marrëdhënieve ndërvepruese me shkollat dhe komunitetin vendor, duke forcuar dialogun mes të rinjve, prindërve dhe mësuesve.

Faqja e internetit **www.shkollaime.org** ka për qëllim informimin e publikut rreth aktiviteteve që zhvillohen në Shqipëri në kuadër të modelit Shkolla si Qendër Komunitare (SHQK), duke shërbyer si një medium i përbashkët komunikimi i të gjithë aktorëve që zbatojnë modelin SHQK.

Faqja e facebook @shkollaime.shqk ndan në kohë reale aktivitetet e çdo shkolle me nxënësit në kuadër të modelit Shkolla si Qendër Komunitare.